

Raporti Vjetor

2025



ALPEX
Albanian Power Exchange



Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX Sh.a

Përmbledhje Ekzekutive

Gjatë vitit 2025, Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX Sh.a, konsolidoi rolin e saj institucional dhe operacional si Operator i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për zonat e ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës me një rritje të qëndrueshme. Ky vit u karakterizua si një treg i maturuar në rritje me operimin e bashkimit të tregjeve të ALPEX-it në mënyrë të sigurtë dhe vazhdimin e ruajtjes së standardeve të tregjeve evropiane të energjisë elektrike.

Volumet totale të tregtuara në tregjet e ALPEX-it arritën në vlerën **1,670,734.1 MWh**, duke shënuar një rritje prej **42.46%** krahasuar me vitin 2024. Faturimi total i transaksioneve në blerje-shitje arriti në **369.46 milionë Euro**, ndërsa çmimi mesatar klerues ishte **118.38 €/MWh**, duke reflektuar rritjen e likuiditetit, pjesëmarrjen më të gjerë të aktorëve të tregut dhe një funksionim të mirë të procesit të çmim-formimit brenda kornizës së Tregjeve të Ditës në Avancë dhe atij të Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë.

Bashkimi i Tregjeve të Ditës në Avancë ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës ka funksionuar në mënyrë të sigurtë, me asnjë rast të Ndarjes së Plotë të Tregjeve (decouple). Rrjedhja totale e energjisë ndërkufitare arriti në vlerën **351,152.95 MWh**, duke konfirmuar përdorimin eficient të kapaciteteve ndërkufitare dhe prodhuar çmime të njëjta midis dy zonave të ofertimit në 99.04% të MTU-ve.

ALPEX konsolidoi gjithashtu funksionimin e Tregut të Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë (CRIDA-ve). Gjatë vitit 2025, u tregtua një volum total prej **29,442.24 MWh**, me një çmim mesatar klerues prej **139.17 €/MWh**. Tregjet e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë ju krijojnë mundësi Anëtarëve të Bursës me fleksibilitet shtesë dhe mbështetje të sistemit të balancimit afatshkurtër dhe optimizimin e portofoleve në linjë me praktikën më të mira të tregut evropian Brenda së Njëjtës Ditë.

Besimi i tregut mbi aspektet operationale dhe qeverisëse të ALPEX-it vazhdoj me rritje. Gjatë vitit 2025 ALPEX mirëpriti **11 Anëtarë të rinj Burse** dhe **1 Anëtar të ri të Përgjithshëm Klerimi**, duke arritur numrin total prej **45 Anëtarë Burse** dhe **5 Anëtarë të Përgjithshëm Klerimi** në fund të vitit.

Në planin institucional dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar, viti 2025 u karakterizua nga zhvillime kyçe, përfshirë nënshkrimin e marrëveshjes NDA në nivel ENTSO-E, pranimin si vëzhgues në SDAC dhe SIDC, si dhe pranimin si vëzhgues në Italian Borders Working Table (IBWT). Këto zhvillime prezantojnë hapa të rëndësishëm të rritjes së bashkëpunimit me NEMO-t dhe OST-të evropiane dhe duke avancuar më tej përputhshmërinë me kuadrin rregullator, operacional dhe teknik të tregut të brendshëm evropian të energjisë elektrike.

Në përfundim, performanca e ALPEX gjatë vitit 2025 dëshmon stabilitet operacional, rritje të qëndrueshme të tregut dhe përputhshmëri në rritje me standardet evropiane të tregtimit të energjisë elektrike. Këto rezultate krijojnë një bazë solide për thellimin e mëtejshëm të likuiditetit, forcimin e integritetit rajonal dhe avancimin gradual drejt integritetit të plotë në tregun e vetëm Evropian të energjisë elektrike.

ALPEX është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe operimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike për zonat e ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës. Në përmbushje të këtyre përgjegjësiave më poshtë listohen disa prej hapave që janë ndërmarrë dhe realizuar përgjatë viteve:

- Më datën 29 Shtator 2022, ALPEX licencohet për Veprimtarinë e Operatorit të Tregut të Energjisë Elektrike nga ERE;
- Më datën 11 Prill 2023 u krye ankandi i parë për ditën e livrimit 12 Prill 2023 në Tregun e Ditës në Avancë për zonën e ofertimit të Shqipërisë;
- Më datën 17 Korrik 2023, ALPEX përcaktohet si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) nga ERE;
- Më datën 17 Korrik 2023, ALPEX përcaktohet si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për Zonën e Ofertimit të Kosovës nga ZRrE;
- Më datën 31 Janar 2024 u krye ankandi i parë për ditën e livrimit 1 Shkurt 2024 në Tregun e Ditës në Avancë për zonën e ofertimit të Kosovës, së bashku me Bashkimin e Tregut të Ditës në Avancë Shqipëri-Kosovë;
- Më datën 24 Maj 2024 ALPEX pranohet si vëzhgues në All NEMO Committee;
- Më datën 11 Dhjetor 2024 u krye ankandi i parë për ditën e livrimit 12 Dhjetor 2024 në Tregun e Ankandeve Brenda së Njëjtës Ditë (CRIDA) për zonën e ofertimit të Shqipërisë dhe Kosovës, duke shënuar edhe bashkimin e këtij tregu ndërmjet dy vendeve;
- Më datën 14 Janar 2025 ALPEX firmosi NDA (Non-Disclosure Agreement) në nivel ENTSO-E;
- Më datën 07 Shkurt 2025 ALPEX pranohet si vëzhgues në SDAC dhe SIDC;
- Më datën 24 Shtator 2025 ALPEX pranohet si vëzhgues në IBWT (Italian Borders Working Table);

Përgjegjësitë dhe funksionet kryesore të ALPEX

Operimi i platformës elektronike të Tregimit dhe Klerimit

- Regjistrimi i Anëtarëve të Bursës dhe Anëtarëve të Klerimit.
- Sigurimi i aksesit të Anëtarëve të Bursës në ETSS për dorëzimin e urdhërporosive dhe Anëtarëve të Klerimit në EMCS për vendosjen e Kufirit të Kreditit për Anëtarët e Bursës.
- Publikimi i rezultateve për tregjet e ALPEX-it.
- Klerimi dhe Shlveria e Transaksioneve.

Menaxhimi i Tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike

- Administrimi i kërkesave për Anëtarësim në Bursë të Anëtarëve të Bursës dhe Anëtarëve të Përgjithshëm të Klerimit.
- Trajtime dhe certifikime për Agjentët Tregtarë dhe Agjentët Klerues
- Monitorimi dhe mbikëqyrja e Tregut të organizuar të energjisë elektrike

Tregu i Ditës në Avancë


Treguesit kryesore të tregtimit në Tregun i Ditës në Avancë (DAM) për vitin 2025

- Volumi total i tregtuar arriti në **1,641,291.86 MWh** në Tregun e Ditës në Avancë;
- Rrjedha e energjisë ndërkufitare arriti në 351,152.95 MWh;
 - Nga Shqipëria drejt Kosovës: 209,779.02 MWh;
 - Nga Kosova drejt Shqipërisë: 141,373.92 MWh;
- Çmim Mesatar Ditor Klerues ishte **118.38 €/MWh**, ndërkohë çmimi maksimal arriti në vlerën 262.10 €/MWh dhe çmimi minimal 44.78 €/MWh;
- Oferta në blerje: arriti në 2,811,090.48 MWh;
- Oferta në shitje: arriti në 2,719,930.84 MWh;
- Rekordi i tregtimit për një Njësi Kohore të Tregut (MTU) i përket MTU 11 datë 27 Tetor 2025, në vlerën 728.49 MWh.
- Rekordi ditor i tregtimit i faturuar për anëtarët e bursës ishte **9,422.84 MWh** në 27 Nëntor 2025.
- Rekordi i tregtimit mujor i përket muajit Gusht me vlerë **175,121.52 MWh**.
- Rekordi mujor për rrjedhën e energjisë u regjistrua në muajin Nëntor me 49,260.91 MWh.


Tregjet e ALPEX-it të Ditës në Avancë			
Viti 2025	Çmimi për MTU (€/MWh)	Çmimi Ditor (€/MWh)	Volumet në DAM (MWh)
Mesatare	€ 123.79	€ 118.38	4,496.69
Maksimale	€ 600.00	€ 262.10	9,422.84
Minimale	€ 0.10	€ 44.78	1,834.98
Total Mujor			1,641,291.86

Performanca e Tregut të Ditës në Avancë (DAM)			
Periudha	Volumet (MWh)	Faturimi Blerje-Shitje (€)	Çmimi Mesatar (€/MWh)
2024	1,172,580.58	€ 250,562,250	€ 112.01
2025	1,641,291.86	€ 369,455,328	€ 118.38
Ndryshimi (%)	↑ 39.97%	↑ 47.45%	↑ 5.68%

Çmimi mesatar Klerues dhe Volumet e Tregtuara në baza mujore



Volumet mujore ne DAM të tregtuara -2025 vs 2024




Zona e Ofertimit të Shqipërisë për Tregun e Ditës në Avancë (DAM)

Periudha	Volumet (MWh)	Faturimi Blerje-Shitje (€)	Çmimi Mesatar (€/MWh)
2024	807,328.67	€ 145,998,317	€ 112.01
2025	1,017,823.87	€ 187,936,527	€ 118.24
Ndryshimi (%)	↑ 26.07 %	↑ 28.72 %	↑ 5.56 %


Zona e Ofertimit të Kosovës për Tregun e Ditës në Avancë (DAM)

Periudha	Volumet (MWh)	Faturimi Blerje-Shitje (€)	Çmimi Mesatar (€/MWh)
2024	635,396.02	€ 104,563,932	€ 114.00
2025	974,620.89	€ 188,690,992	€ 118.51
Ndryshimi (%)	↑ 53.38 %	↑ 80.45 %	↑ 3.95 %


Çmimi orar Mesatar Klerues në DAM (€/MWh) - 2025



Volumet mesatare të Tregtuara për MTU në DAM (MWh)-2025



Kërkesat për blerje dhe transaksionet në MWh-2025




Tregu i Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë

Treguesit kryesore të tregimit në Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë (CRIDA-t) për vitin 2025

- Një volum total prej **29,442.24 MWh** i energjisë elektrike u tregtua në Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë me një çmim klerues mesatar prej **139.17 €/MWh**.
- Rrjedha e energjisë ndërkufitare arriti në 22,945.73 MWh:
 - Nga Shqipëria drejt Kosovës: 11,396.36 MWh.
 - Nga Kosova drejt Shqipërisë: 11,549.37 MWh.

Në Vitin 2025, 31 Anëtarë të Bursës janë Anëtarësuar edhe në Tregun e Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë (CRIDA).

Tregu i Ankandeve Brenda të Njëjtës Ditë		
Viti 2025	Çmimi klerues në CRIDA (€/MWh)	Volume në CRIDA (MWh)
Mesatar ditor	€ 139.17	150.99
Max. ditor	€ 750.28	1,447.97
Min. ditor	€ 1.14	0.01
Total 2025		29,442.24



Volumet mesatare të tregtuara në CRIDA-t për MTU (MWh) -2025

